



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.6 Regj.Them.
Datë Rregj. 03.04.2021

Nr.5 VENDIMI
Datë 04.04.2021

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: Manjola XHAXHO (*Relatore*)
Gjyqtar: Gentian MEDJA (*Anëtar*)
Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Anëtare*)
Gjyqtare: Esmeralda ÇEKA (XHILI) (*Anëtare*)
Gjyqtar: Asim VOKSHI (*Anëtar*)

asistuar nga sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, më datë 04.04.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. 6 akti, datë 03.04.2021 që i përket:

PADITËS: Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD) “PD-AN” përfaqësuar në gjykim nga Z. Ivi Kaso.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim nga juristi Z. Blendi Kodra.

PERSONA TË TRETË: Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga Av. Eridian Saijanji.
Partia Bindja Demokratike, përfaqësuar në gjykim Z. Fabjan Topallari.

NDËRHYRËS DYTËSOR: Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, nga Av. Altin Kaziaj.

OBJEKTI: 1. Kundërshtimi i vendimit të KQZ/KAS nr. 19, datë 03.04.2021
“Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr.08 të

Partisë Socialiste të Shqipërisë, nr. 09 të Partisë Bindja Demokratike dhe nr. 10 të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN) ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021”.

2. Gjykimi i çështjes në themel duke vendosur pranimin e kërkesës ankimore nr. 10 të paraqitur nga Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN) dhe rrëzimin e kërkesave ankimore nr. 08 dhe nr. 09 të paraqitura nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Bindja Demokratike.

BAZA LIGJORE:

Nenet 66, 67, 98 dhe 145 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, analizoi provat dhe ligjin, si dhe dëgjo pretendimet e palëve, të cilat në përfundim të gjyqimit kërkuan:

Pala paditëse, Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN):

- Pranimin e padisë sipas objektit.

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

- Lënien në çmim të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor zgjidhjen e mosmarëveshjes.

Personi i tretë, Partia Socialiste e Shqipërisë:

- Rrëzimin e padisë.

Personi i Tretë, Partia Bindja Demokratike:

- Rrëzimin e padisë.

Ndërhyrësi dytësor, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim:

- Pranimin e padisë.

VËREN:

1. Se pala paditëse subjekti zgjedhor, Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim “PD-AN” i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor (në vijim Kolegji) me kërkesëpadi më datë 03.04.2021, duke kërkuar “*Kundërshtimin e vendimit të KQZ/KAS, nr. 19 datë 03.04.2021 “Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr.08 të Partisë Socialiste të Shqipërisë, nr. 09 të Partisë Bindja Demokratike dhe nr. 10 të Koalicionit Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim (PD-AN) ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021; si dhe gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e kërkesës ankimore nr.10 të paraqitur nga Koalicioni Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim (PD-AN) dhe*

rrëzimin e kërkesave ankimore nr. 08 dhe nr. 09 të paraqitura nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Bindja Demokratike.”

2. Subjekti zgjedhor, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim i është drejtuar Kolegjit më datë 04.04.2021 me kërkesë për ndërhyrje dytësore në çështjen objekt gjykimi për t’u bashkuar me palën paditëse për kërkimin e padisë për kundërshimin dhe ndryshimin e vendimit të KQZ/KAS nr. 19, datë 03.04.2021 në lidhje me variantin e miratuar të fletës së votimit. Në lidhje me këtë kërkesë procedurale pala paditëse, pala e paditur dhe pala e tretë Partia Bindja Demokratike u shprehën për pranimin e saj, pala e tretë Partia Socialiste e Shqipërisë e la në çmim të Kolegjit. Kolegji duke çmuar se Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, si subjekt zgjedhor ka interes në lidhje me çështje objekt, me vendim të ndërmjetëm vendosi të pranojë kërkesën për ndërhyrje dytësore duke u bashkuar kjo palë me paditësit në këtë gjykim në bazë të nenit të 191 KPrC që parashikon ndër të tjera se *Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes për të mbështetur njërin ose tjetrën palë, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë.*

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

3. Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

4. Në përfundim të afatit për regjistrimin e listave shumemërore në KQZ, janë regjistruar gjithsej dy koalicione zgjedhore, koalicioni me shkronja nistore (PD-AN) dhe koalicioni me shkronja nistore (ABEOK), 10 (dhjetë) parti politike, dhe 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit.

5. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit të listave shumemërore, në mbështetje të nenit 98, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (në vijim KSHZ) organizoi hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen. Me vendimin nr. 168, datë 18.03.2021, Komisioneri miratoi rezultatin e shortit duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit. Renditja në fletën e votimit për kandidatët për deputet në 12 zonat zgjedhore do të bëhet sipas numrit rendor të dalë nga rezultati i shortit për partitë politike, të cilat kanë depozituar lista shumemërore sipas materialeve bashkëlidhur këtij vendimi.

6. KSHZ me vendimin nr. 198, datë 01.04.2021 “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021” (që ndodhet në dosjen gjyqësore), në pikën 1 të tij, vendosi ndër të tjera: *Miratimin e fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill, 2021 me përmbajtje sipas shtojcave respektive për çdo qark, në*

formatin landscape, duke përshtatur sipas numrit të kandidatëve, madhësinë e fontit dhe stilizimet e logove, për çdo qark.

7. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është përballuar me diskutime nga subjektet politike në lidhje me :

A) *Me përmbajtjen e fletëve të votimit dhe konkretisht:*

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka parashtruar se: Modeli i fletës së votimit që do të merret në shqyrtim të jetë ai në përmbajtje të së cilës kandidatët janë të shënuar vetëm sipas numrave të renditur në listat shumëmemërore. Bazuar në nenin 98, pika 4 të Kodit Zgjedhor, konfigurimi i fletës së votimit duhet të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin, duke i lehtësuar këtij të fundit orientimin për votimin si të subjektit zgjedhor, ashtu edhe të kandidatit të parapëlqyer. Gjithashtu, neni 106 i Kodit Zgjedhor, sanksionon procedurën e votimit. Në pikën 1, të neni 106, Kodi Zgjedhor i njuh të drejtën zgjedhësit që pasi merr fletën e votimit, të shënojë në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhore dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor, shenjën që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Në zbatim të dispozitave të lartpërmendura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim të ndërmjetëm vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për shqyrtimin e versionit të fletës së votimit në përmbajtje të së cilës kandidatët janë të shënuar vetëm sipas numrit të renditur në listën shumëmemërore të paraqitur prej tyre si subjekt zgjedhor. Subjekti zgjedhor, Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim PD-AN”, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka parashtruar se: Modeli i fletëve të votimit që do të miratohen të jetë në formatin portrait. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rrëzoi kërkesën me arsyetimin se fleta e votimit në formatin landscape përmbush kërkesat ligjore të pikës 4, të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, dhe respekton kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, e konfigurimi i saj të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësit, si dhe

B) *Është diskutuar edhe shqetësimi i ngritur nga subjekti zgjedhor Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim PD-AN”, për emblemën (siglën) e depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Bindja Demokratike BD”. Neni 66, i Kodit Zgjedhor, parashikon se nëse dy parti ose koalicione kanë emër ose emblemë të njëjtë apo të ngjashme në atë masë sa që mund të shkaktojë konfuzion ose lajthitje të votuesve, atëherë KQZ vendos cila parti ose koalicion ka të drejtë të përdorë emrin ose emblemën përkatëse për qëllime zgjedhore, duke marrë në konsideratë datën e themelimit ligjor të partive ose datën e regjistrimit të parë të koalicionit në KQZ. Për të përcaktuar datën e parë të regjistrimit të koalicioneve KQZ-ja i referohet edhe zgjedhje të mëparshme. Bazuar në këtë nen subjekti zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim PD-AN”, ka vërejtur se emblema (sigla) e propozuar nga “Partia Bindja Demokratike BD”, është shumë e ngjashme dhe krijon konfuzion/lajthitje të votuesve me emblemën (siglën) e Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim PD-AN”. Ky pretendim u diskutua midis palëve gjatë zhvillimit të seancës dhe në zbatim të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u vlerësua që subjekti zgjedhor “Partia Bindja Demokratike BD”, të përdorë një emblemë të ndryshme nga ajo e propozuar.”*

8. Kundër vendimit të KSHZ-së nr. 198, datë 1.4.2021 kanë ushtruar ankim :

A) Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, duke parashtruar ndër të tjera se:

Përmbajtja dhe konfigurimi i fletës së votimit i miratuar nga KSHZ konstatohet me një numër të lartë të emrave të kandidatëve dhe rrjedhimisht sjell një vështirësi substanciale në procesin e përzgjedhjes së kandidatit apo subjektit të preferuar. Votuesi do e ketë të vështirë orientimin në fletë në mënyrë që shënimi në fletën e votimit të korrespondojë me kandidatin që ai dëshiron që të jetë përfaqësuesi i tij në Kuvend. Varianti i miratuar i fletës së votimit krijon një gjendje pabarazie të votuesve në zonat zgjedhore apo qarqe të ndryshme. Varianti i fletës së votimit të miratuar vjen në kundërshtim me vendimin nr. 168, datë 18.03.2021 “Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021” të KSHZ-së, i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga asnjë palë e interesuar. Varianti i fletës me numra është varianti më i përshtatshëm, sepse duke marrë në konsideratë situatën aktuale, është më e qartë dhe e thjeshtë për votuesin kur të paraqitet në dhomën e fshehtë. Fleta e votimit me numra është në përputhje me vendimin nr. 168, datë 18.03.2021 të KSHZ-së, pasi emrat e subjekteve zgjedhore janë të konfiguruar në përputhje me konfigurimin e tyre në këtë vendim. Për pasojë, vendimi nr. 198, datë 01.04.2021 i KSHZ-së duhet të ndryshohet dhe të miratohet fleta e votimit për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë sipas variantit të paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ku në përmbajtje të saj, kandidatët të identifikohen me numra.

B) Subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike, duke parashtruar ndër të tjera se:

Pasqyrohet në faqen zyrtare të KQZ-së fleta e votimit ku si sigël e Partisë Bindja Demokratike ishte një sigël që nuk ka lidhje me siglën tonë të ristilizuar, dhe që nuk është dërguar nga subjekti ankues. Për këtë arsye, Partia Bindja Demokratike kërkon pasqyrimin e siglës që është paraqitur nga vetë subjekti në përgjigje të shkresës nr. 3010 prot. të KSHZ-së.

C) Subjekti zgjedhor, koalicioni “Partia Demokratike □ Aleanca për Ndryshim” (PD-AN), duke parashtruar ndër të tjera se:

c.1) Versioni i fletës së votimit i miratuar nga KSHZ-ja vjen në kundërshtim me kriterin e qartësisë që parashikon neni 98, pika 4 e Kodit Zgjedhor. Versioni i propozuar nga KSHZ në mbledhjen e datës 31.03.2021, drejtuar Komisionit Rregullator, me po të njëjtën përmbajtje por me orientimin “portrait” dhe jo “landscape” (si dhe u miratua) është më i qartë dhe i kuptueshëm për zgjedhësit. Gjithashtu, nga një sondazh që KQZ ka bërë në faqen e saj zyrtare për të gjitha modelet e fletëve të votimit, fleta e votimit e cila përshkruan kandidatët me emra por ne orientimin “portrait” është ajo që ka marrë mbështetjen më të madhe nga votuesit (79%).

c.2) Emblema e subjektit zgjedhor Bindja Demokratike është shumë e ngjashme dhe krijon konfuzion dhe lajthitje të votuesve me emblemën e subjektit zgjedhor koalicionit “Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim” (PD-AN). Duke konsideruar se emri i koalicionit dhe sigla përkatëse janë historike dhe figurojnë të tilla në të gjitha proceset zgjedhore pas vitit 1991, mbështetur në nenin 66 të Kodit Zgjedhor duhen marrë masat përkatëse. Për këto arsye, vendimit nr., 198, datë 01.04.2021 i KSHZ-së duhet ndryshuar vetëm për pjesën që disponon mbi

orientimin “landscape” dhe jo “portrait” të fletës së votimit, dhe mbi lejimin e përdorimit të fletës së votimit pa logon e subjektit Bindja Demokratike.

9. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) me vendimin nr. 19, datë 3.4.2021 (që ndodhet në dosjen gjyqësore), ka vendosur: *1. Ndryshimin e vendimit nr.198, datë 01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. 2. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 08 të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë. 3. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 09 të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, duke vendosur në përmbajtje të fletës së votimit logon e ristilizuar të depozituar nga ky subjekt. 4. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 10, të paraqitur nga Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim. 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.*

10. Sipas këtij vendimi KAS ka arsyetuar ndër të tjera se:

“KAS-i është i detyruar të konstatojë dhe pranojë faktin se kundër vendimit nr.12, datë 31.3.2021 për shpalljen e moskompetencës nga Rregullatori nuk ka bërë ankim asnjëra nga palët. Mungesa e ankimit specifik e bën vendimin e Rregullatorit detyrues për Komisionerin, i cili nga ana e tij nuk mund të shpallte moskompetencën, sa kohë që një akt me fuqi detyruese e ngarkonte me miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit. Mbi të njëjtin arsyetim ligjor, KAS-i nuk mund të konstatojë pavlefshmërinë e vendimit të Komisionerit nr.198, datë 1.4.2021, sa kohë që vendimi ka dalë në bazë të një akti të Rregullatorit, i cili është në fuqi. KAS-i është i detyruar të shqyrtojë dhe zgjidhë në themel ankesën. Në vendimin e tij nr.6, datë 26.2.2021 Komisioni Rregullator ka miratuar specifikimet teknike të fletës së votimit. Në rrethin e specifikimeve teknike bën pjesë edhe përcaktimi i përmasave të fletës së votimit. Sipas shtojcës së vendimit të sipërcituar, përmasat e fletës së votimit për zgjedhjet e datës 25.04.2021 do të jenë: gjerësia 297mm dhe gjatësia 420mm. Ky vendim është detyrues për Komisionerin si dhe për KAS për sa i përket përmasave të fletës . Miratimi i fletës së votimit me përmasa të ndryshme nga ato të miratuara me vendimin e Rregullatorit të sipërcituar përbën shkelje, e cila në vetvete përbën shkak ligjor për shfuqizimin e vendimit të Komisionerit nr. 198, datë 01.04.2021. ...Nga analiza ligjore e çështjes KAS-i konstaton se Kodi Zgjedhor ka vendosur hapësirë diskreciale për KQZ-në në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskreciale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesmarrëse mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por Kodi, bashkë me diskrecionin, i ka caktuar KQZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me: fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore (neni 97, pika 1); fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie (neni 98, pika 1); emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri

i kryetarit të partisë (neni 98, pika 3); çdo subjekti që renditet në fletën e votimit duhet t'i korrespondojë hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi (neni 98, pika 3). fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (neni 98, pika 4). E drejta e KQZ-së për të kompozuar informacionin e fletës së votimit, sidomos përse i përket mënyrës së votimit parapëlqyes duhet të respektojë kushtet: informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar; konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer (neni 98, pika 4). Formulimi i pikës 4 të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, nënkupton se KQZ-ja ka të drejtën ligjore të zgjedhë sasinë e informacionit për votimin parapëlqyes që do të përfshijë në fletën e votimit, në varësi nga nevoja për ta mbajtur fletën e votimit të thjeshtë, me konfigurim të qartë e të kuptueshëm dhe me orientim të lehtë. Nëse informacioni për votimin parapëlqyes është i ngarkuar, atëherë KQZ-ja është e detyruar të thjeshtojë informacionin, deri në minimumin e mundshëm për votim. Fleta e votimit, me emrat e kandidatëve të listës, me numrin rendor përbri dhe me hapësirën për votën parapëlqyese përbën maksimumin e mundshëm të informacionit që mund të përfshihet në fletën e votimit për kandidatët. Thjeshtimi, dhe lehtësimi nënkuptojnë zgjidhje që janë më pak se kaq. Lehtësimi do të thotë heqja e emrave të kandidatëve nga fleta e votimit (e pjesshme ose e plotë). Thjeshtimi do të thotë unifikimi i hapësirës për votim me hapësirën e numrit rendor, e ndjekur nga disa alternativa për mënyrën e votimit. Sa i përket kompozimit të fletës së votimit, interesi i zgjedhësve është interes madhor në raport me interesin e subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve të tyre. Fleta e votimit nuk është në shërbim të subjekteve dhe kandidatëve, por është në shërbim të drejtpërdrejtë të zgjedhësve. Për më tepër, kompozimi i saj ka ndikim të drejtpërdrejtë tek lehtësimi i procedurave të votimit e të numërimit të votave, tek ruajtja e fshehtësisë së votimit, si dhe tek ulja e rasteve të pavlefshmërisë apo të votimit të gabuar. Interesat e subjekteve dhe të kandidatëve të tyre nuk janë domosdoshmërisht në harmoni me interesin e votuesve në këtë pikë. Preferencat e tyre mund të shkojnë drejt pozicionimit të subjektit në fillim apo në fund të fletës së votimit, për të përfituar nga lehtësia në votim, mund të jenë për një fletë votimi me përmasa të mëdha, e cila mundëson "leximin" e votës nëpërmjet pozicionimit dhe lëvizjeve trupore që bën votuesi kur voton në fillim të një flete të madhe, apo kur voton në fund të saj, mund të jenë për zgjatjen në kohë të procesit të votimit, me qëllim që procesi të zvarritet dhe eventualisht një pjesë e votuesve të mbeten pa votuar, sikurse mund të jenë për vështirësimin e votimit, me qëllim që pavlefshmëria në votim të jetë e lartë. Asnjë nga këto preferenca, në rastin konkret nuk nënkupton se subjekti është i motivuar nga keqdashja apo keqbesimi, por KQZ-ja duhet të kujdeset apriori që vendimarrja e saj të mos lehtësojë apo favorizojë keqdashjen ose keqbesimin. Për këtë arsye, KQZ-ja nuk mund të vendosë si objektiv konsensusin publik apo midis subjekteve zgjedhore kur kompozon fletën e votimit, por duhet të kujdeset që të plotësojë pa kompromis nevojat e votuesve për fletë votimi të thjeshtë, të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë në orientim. Praktikrat e vendeve të tjera që përdorin mënyra të ngjashme votimi kanë shkuar drejt respektimit të nevojave të zgjedhësve dhe jo të kërkesave të subjekteve. Në Itali, fleta e votimit përmban si informacion vetëm emrat e udhëheqësve të listës (dy, tre apo katër), por jo listën e plotë të kandidatëve. Në Kosovë votimi

parapëlqyes bëhet mbi numra, informacioni korrespondues për kandidatët jepet me bollëk brenda mjediseve të qendrës së votimit, por jo në fletën e votimit. Emrat e kandidatëve të listës janë pjesë e fletës së votimit vetëm në praktikën e votimit në Greqi, por modeli grek është i papajtueshëm ligjërish me modelin tonë të votimit. Përfshirja e njëqind përqind të informacionit për kandidatët në fletën e votimit, sikurse është bërë nga Komisioneri me vendimin nr.198, datë 1.4.2021, ka rritur përmasën e fletës së votimit. Përveç argumentit ligjor të trajtuar më sipër, ky fakt përbën shqetësim real për procesin e votimit, sepse përmasa e ekstremisht e madhe e fletës së votimit vështirëson përdorimin e saj përgjatë procesit të votimit, rrezikon tejmbushjen e kutive për shkak të madhësisë së fletës, kompromenton fshehtësinë e votimit, ngarkon administrimin përgjatë numërimit të votave, si dhe rrit potencialin manipulativ në numërim, vecanërisht për votët parapëlqyese të kandidatit. Përpos këtyre rreziqeve evidente, modeli i miratuar me këto përmasa rrit në mënyrë të pajustificueshme koston e prodhimit të tyre. Komisioneri duhet të kishte analizuar, eksperimentuar dhe zgjidhur pozitivisht eliminimin e këtyre rreziqeve të procesit, përpara se të miratonte këtë fletë votimi. Zgjidhja e dhënë për zvogëlimin e madhësisë së fontit, me qëllim që të sistemohen brenda fletës së votimit emrat e të gjithë kandidatëve që garojnë në zonën zgjedhore shkon dy herë në dëm të zgjedhësve, një herë për shkak të zvogëlimit të gërmës, të dytën për shkak të tejmbushjes me informacion. Kodi zgjedhor kërkon në mënyrë taksative që fletët e votimit të kenë të njejtën ngjyrë dhe të njejtën formë në të gjitha zonat zgjedhore. Por Kodi nuk kërkon që fletët e votimit të kenë të njejtën përmasë dhe të njejtën përmbajtje në të gjitha zonat. Komisioneri mund të kishte marrë në konsideratë këtë hapësirë ligjore dhe t'i kishte rekomanduar Rregullatorit që të adoptonte zgjidhje alternative nga një zonë në tjetrën, për të pajtuar kërkesat e subjekteve me nevojën për të mbajtur fletën e votimit të thjeshtë, të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë në orientim. Një gjë e tillë mund të realizohej p.sh. me fletën e votimit në Kukës, ku garojnë 12 subjekte dhe 36 kandidatë, e cila krijon mundësi krejtësisht të tjera krahasuar me fletën e votimit në Tiranë, ku garojnë 13 subjekte dhe 433 kandidatë. Përtej arsyetimit parimor, KAS-i këqyri modelet e fletës së votimit që u ishin prezantuar Rregullatorit dhe Komisionerit dhe çmon se, midis tyre, kërkesat ligjore i plotëson më mirë fleta e votimit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Lidhur me kërkesën ankimore të subjektit Bindja Demokratike (BD) dhe kërkesën me të njejtin objekt të koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-AN), KAS-i konstaton se arsyetimi i Komisionerit se subjekti BD duhet të ndryshojë logon me të cilën paraqitet në fletën e votimit, nuk gjen mbështetje në ligj. Në shqyrtimin e kontestimeve të kësaj natyre, Komisioneri duhet të merrte në konsideratë, të gjykonte dhe të vendoste: nëse logot janë të ngjashme në atë masë që mund të shkaktojnë konfuzion tek zgjedhësi; cili nga subjektet ka të drejtën të ruajë logon dhe cilit duhet t'i kërkohej të depozitonte një logo të re. Komisioneri nuk e ka tagrin që të caktojë ai një logo të re për subjektin, kundër vullnetit të këtij të fundit, sidomos nuk ka të drejtë që të kushtëzojë vendimarrjen e tij me miratimin nga njëri apo tjetri subjekt. Neni 66 i Kodit Zgjedhor përcakton se për të caktuar precedencën në përzgjedhjen e logos KQZ-ja merr në konsideratë “datën e themelimit ligjor të partive ose datën e regjistrimit të parë të koalicionit në KQZ. Për të përcaktuar datën e parë të regjistrimit të koalicioneve, KQZ-ja i referohet edhe zgjedhjeve të mëparshme”. Subjekti zgjedhor BD ka datë të themelimit ligjor datën 25.4.2019, në të cilën

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka regjistruar si person juridik. Koalicioni zgjedhor PD-AN është regjistruar në zgjedhje për herë të parë më datë 2.3.2021, me vendimin e Komisionerit nr.107, si bashkim i 13 partive politike. KAS-i konstaton se data më e hershme e themelimit e subjektit BD, në kuptim të rregjistrimit si subjekt zgjedhor garues në këto zgjedhje, i jep atij precedencën sipas nenit 66 të Kodit. Pavarësisht nga kjo, KAS-i çmon se këqyrja e fletës së votimit, në të gjitha modelet e përgatitura nga administrata e KQZ-së, përfshirë të dhënat për emërtimin dhe siglën e subjektit, emrin e kryetarit të partisë, logon dhe pozicionimin e subjekteve larg njeri tjetrit në fletën e votimit çon në përfundimin se nuk ka shkaqe ligjore dhe faktike për të hamendësuar konfondimin e zgjedhësve për shkak të logove të subjekteve BD dhe PD-AN. Vlen të theksohet se subjekti ankues BD, me kërkesë të Komisionerit ka pranuar të ndryshojë logon e parë të depozituar fillimisht për këtë proces zgjedhor, duke ristilizuar logon me qëllim përfshirjen elementeve që e bëjnë të dallueshme atë. Konkretisht, nga pikëpamja vizuale dhe fonetike, në variantin e ristilizuar kemi pasqyrimin e emrit (Bindja Demokratike) e cila dallon nga logo e parë e depozituar që kishte vetëm shkronjat nistore të inkuadruara në simbolin/logo. Po ashtu edhe nga pikëpamja konceptuale, tek logo e ristilizuar kemi ndryshime (psh: ngjyra më e çelur) që e bëjnë akoma më të theksuar dallimin me logon e subjektit PD-AN. Pretendimi i ankuesit PD-AN, se në mospranim të logos se vendosur (ndryshuar) nga Komisioneri, në alternativë, logo e subjektit DB duhet të hiqet nga fleta , duke garuar vetem me emër, është i pabazuar në nenin 66 të Kodit Zgjedhor si dhe parimet e përgjithshme kushtetuese e ligjore që garantojnë barazinë e palëve në procesin zgjedhor, duke përfshirë të drejtën të identifikohen më një logo të zgjedhur prej tyre. Po ashtu pretendimet e subjektit zgjedhor PD-AN, lidhur me ndryshimin e vendimit të Komisionerit, duke miratuar një fletë të njëjtë në përmbajtje në orientimin portrait dhe jo landscape, për sa arsyetohet me sipër, nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe prova dhe si të tilla nuk mund të pranohen nga KAS.”

11. Kundër vendimit nr. 19, datë 3.4.2021 të KAS ka paraqitur padi pranë Kolegjit subjekti zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim “PD-AN” me objekt të cituar në pjesën hyrëse të vendimit. Palës paditëse në gjykim iu bashkua ndërhyrësi dytësor, subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

12. Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim “PD-AN” në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, ngriti pretendimet e mëposhtme:

Së pari: Pavarësisht se vendimmarrja e KSHZ me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 është e drejtë dhe respekton kriteret e parashikuara në nenin 98 pika 4 të Kodit Zgjedhor, pasi parashikon identifikimin me numër dhe me emër të kandidatëve të secilit subjekt zgjedhor ajo vjen në kundërshtim me kriterin e qartësisë që kjo dispozitë parashikon. Versioni i propozuar nga vet KSHZ në mbledhjen e datës 31.03.2021, drejtuar Komisionit Rregullator, me po të njëjtën përmbajtje por me orientimin “portrait” dhe jo “landscape” (si dhe u miratua) është më i qartë dhe i kuptueshëm për zgjedhësit. Gjithashtu, nga një sondazh që KQZ ka bërë në faqen e saj zyrtare për të gjitha modelet e fletëve të votimit, fleta e votimit, e cila përshkruan kandidatët me emra por në orientimin “portrait” është ajo që ka marrë mbështetjen më të madhe nga votuesit

(79%). Në këtë mënyrë KSHZ duke miratuar një fletë votimi të ndryshme nga ajo që është përzgjedhur si fituese nga qytetaret dhe nga vetë propozimi i tij i mëparshëm dukshëm ka shpërfillur kriterin ligjor të qartësisë së fletës së votimit.

Së dyti: Në datën 30.03.2021 KSHZ, i ka propozuar Rregullatorit projekt aktet përkatëse me përmbajtjen dhe modelin e fletëve të votimit të cilat do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 në të gjitha zonat zgjedhore. Nga shqyrtimi i këtij projekt akti kemi vërejtur se emblema (sigla e propozuar) e subjektit Partia Bindja Demokratike është shumë e ngjashme dhe krijon konfuzion dhe lajthitje të votuesve me emblemën (siglën) e subjektit zgjedhor Koalicionit “Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim”. Kjo situatë është marrë në konsideratë nga legjislatori, i cili në nenin 66 të Kodit Zgjedhor, i cili ka parashikuar zgjidhje për situata të tilla. Duke konsideruar se emri i koalicionit “Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim PD – AN” dhe sigla përkatëse, janë historike dhe të njohura për zgjedhësit, pasi figurojnë të tilla në të gjitha proceset zgjedhore pas vitit 1991, është kërkuar nga ana e Komisionerit marrja e masave përkatëse për zgjidhjen e kësaj problematike duke i ndaluar subjektit zgjedhor “Bindia Demokratike” përdorimin e logos në fletën e votimit sipas modelit të propozuar prej KSHZ në fletën përfundimtare të votimit ka ndryshuar logon e Partisë Bindja Demokratike në marrëveshje me të. Ndërkohë Partia Bindja Demokratike e ka kundërshtuar logon e saj në fletën e votimit të KAS duke kërkuar të vihej logoja e mëparshme. KAS ka me vendimin nr. 19, datë 03.04.2020 ka pranuar këtë kërkesë ankimore, si dhe kërkesën ankimore të Partisë Socialiste në lidhje me fletën e votimit duke miratuar si variat atë ku kandidatët nuk identifikohen me emra por menukra. nuk pasqyrohen emrat e kandidatëve por numrat e tyre.

Së treti: Vendimmarrja e KAS nuk është e bazuar në ligj pasi nuk merr në konsideratë argumentet e ngritura nga pala paditëse në kërkesën ankimore nr. 10 lidhur me atë çka vendimi nr. 198/2021 i KSHZ nuk ishte në përputhje me parashikimet e nenit 98 pika 4 të Kodit Zgjedhor. Kjo e fundit ndonëse është e drejtë dhe respekton përgjithësisht kriteret, pasi parashikon identifikimin me numër dhe me emër të kandidatëve të secilit subjekt zgjedhor, ajo vjen në kundërshtim me kriterin e qartësisë që kjo dispozitë parashikon. Versioni i propozuar nga KSHZ në mbledhjen e datës 31.03.2021 drejtuar Komisionit Rregullator, me të njëjtën përmbajtje por me orientimin “portrait” dhe jo “landscape” (si dhe u miratua) është më i qartë dhe i kuptueshëm për zgjedhësit dhe si i tillë ishte ky variant i cili duhet të miratohej. Gjithashtu, nga një sondazh që KQZ ka bërë në faqen e vet zyrtare, për të gjitha modelet e fletëve të votimit, fleta e votimit e cila përshkrua kandidatët me emra, por me orientimin “portrait” është ajo që ka marrë mbështetjen më të madhe nga votuesit, në një shumicë dërrmuese prej 79 %. Asnjë nga këto argumente nuk u rrëzua gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore në KAS nga asnjë prej palëve të tjera në proces dhe nga ana tjetër nuk është vlerësuar dhe arsyetuar nga ana e KAS në momentin e vendimmarrjes përfundimtare. Vlerësohet se, e vetmja fletë votimi, e cila respekton kriterin e qartësisë dhe kuptueshmërisë të parashikuar nga ligji në paragrafin 4 të nenit 98 është ajo që qartazi ka rezultuar fituese e sondazhit të organizuar nga vetë KQZ i cili është konsultuar nga dhjetra, mijëra përdorues të rrjeteve sociale dhe ka marrë mbështetjen në një përqindje tejet të lartë.

Së katërti: Në mënyrë krejtësisht të papranueshme dhe në kundërshtim flagrant me një dispozitë urdhëruese të ligjit zgjedhor, nenit 66 të tij, KAS ka lejuar që një subjekt në garën zgjedhore të përdorë një logo (emblemë) të ngjashme me emblemën historike të subjektit Paditës, sigël e cila është e njohur prej 30 vitesh dhe familjare jo vetëm për mbështetësit e këtij subjektit, por për të gjithë zgjedhësit në Republikën e Shqipërisë. Shkelja qëndron në faktin që, KAS i ka njohur vetes të drejtën që jo vetëm të verifikojë vendimmarrjen e Komisionerit nr. 198/2021, mbi respektimin e kriterëve strikte formale dhe ligjor të vendimit, por ka marrë tagra që të vlerësojnë edhe ato pjesë të kësaj vendimmarrje, të cilat janë tagër i vetëm dhe ekskluziv i Komisionerit. Ndër to më i rëndësishëm, ai i cili disponon mbi faktin nëse dy sigla të subjekteve të regjistruara për zgjedhje janë të ngjashme ose jo dhe a shkaktojnë konfuzion e ngatërresë të zgjedhësit. Ky element është lënë nga legjislatori në vlerësim ekskluziv dhe si tagër i patjetërsueshëm i Komisionerit dhe mbi këtë tagër nuk mund të mbivendoset vlerësimi diskrecional i anëtarëve të KAS, pasi roli i tyre i parashikuar në Kodin Zgjedhor nuk e lejon një gjë të tillë. Në rast se sikundër ne, ashtu edhe Komisioneri vlerësojnë se siglat e subjekteve janë të ngjashme atëhere asnjë organ tjetër nuk ka tagrin ta vlerësojë në mënyrë të ndryshme një fakt të tillë por vetëm mund të verifikojë aplikimin sipas ligjit të sanksionit përkatës apo jo. Përsa i përket sanksionit në këtë rast ai është një dhe i vetëm. Sipas ligjit ai duhet të merret duke i ndaluar subjektit “Bindja Demokratike” përdorimin e logos në fletën e votimit, sipas modelit të propozuar prej saj, kërkesë e cila nuk është marrë parasysh në vendimmarrjen nr. 198/2021, në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të Kodit Zgjedhor. Aq më tepër nuk duhet të lejohet të zhbëhet në drejtim të kundërt vendimmarrja e KSHZ në këtë pikë, duke mos lejuar as përdorimin e logos së këtij subjekti, sipas disponimit të Komisionerit me vendimin nr. 198/2021 pasi edhe ajo sigël, ndonëse me ndryshime të vogla nga ajo e depozituar nga vetë subjekti në KQZ fillimisht, është aplikuar nga Komisioneri në bashkëveprim me subjektin Bindja Demokratike, si dhe është pranuar nga vetë ky i fundit në seancën publike të zhvilluar nga Komisioneri në datën 01.04.2021. Provë për këtë është fakti që subjekti Bindja Demokratike nuk e ka kundërshtuar këtë pikë gjatë vendimmarrjes së KSHZ, por vetëm disa orë më vonë kësaj vendimmarrje. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë logjikën me të cilën është hartuar dispozita, neni 66 i Kodit Zgjedhor, dispozitë e cila parashikon vetë një sanksion dhe një linjë veprimi, si dhe faktin që aplikimi i saj varet vetëm nga konstatimi i disa fakteve ligjore mbi të cilat s’mund të disponojë askush - tagrin ekskluziv të Komisionerit për të përcaktuar ngjashmërinë ose jo- urdhërimi nuk mund të jetë veçse një dhe i vetëm: Ndalimi i përdorimit të siglës së subjektit Bindja Demokratike në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Argumenti i ngritur nga përfaqësuesi i subjektit Bindja Demokratike, në seancën e shqyrtimit në KAS, se Bindja Demokratike nuk kishte dhënë pëlqimin për përdorimin ndonjë logoje të ndryshme nga ana e Komisionerit, nuk është ligjor, pasi ligji në asnjë vend, e aq më pak në nenin 66, nuk parashikon dhënien e pëlqimit ose jo. Ligji parashikon vetëm ndalimin e përdorimit dhe në këtë pikë në insistojmë në aplikimin e drejtë të tij në këtë rast. Pretendohet se paditësi fiton epërsinë në përdorimin e logos të tij, pasi subjekti politik është historik dhe ka 30 vjet që garon me të njëjtin emër dhe logo në të gjitha garat zgjedhore prej vitit 1991 e deri më sot, çka për efekt të ligjit ka një përparësi të pakrahasueshme me një subjekt politik të krijuar në vitin 2019. I pyetur

nga Kolegji, në gjykim përfaqësuesi i palës paditëse deklaroi se logoja e Partisë Bindja Demokratike në fletën e votimit të miratuar nga KSHZ me vendimin nr. 198/2021, nuk ka ngjashmëri në kuptim të aplikimit të ndalimit të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, në ndryshim nga logoja në fletën e votimit të miratuar nga KAS me vendimin nr. 19/2021, që nuk duhet lejuar.

13. Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë gjykimit paraqiti qëndrimin e mëposhtëm:

Me vendimin nr. 198, datë 1 Prill 2021, “Për miratimin e përmbajjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, KSHZ, pasi dëgjoi pretendimet e subjekteve zgjedhore, vendosi miratimin e fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 me përmbajtje që pasqyron edhe emrat e kandidatëve sipas shtojcave respektive për çdo qark, në formatin landscape, duke përshtatur sipas numrit të kandidatëve, madhësinë e fontit dhe stilizimet e logove. KSHZ arsyetoi vendimmarrjen e tij duke u bazuar në nenin 98, pika 4 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se konfigurimi i fletës së votimit duhet të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin, duke i lehtësuar këtij të fundit orientimin për votimin si të subjektit zgjedhor, ashtu edhe të kandidatit të parapëlqyer. Në pikën 1, të neni 106, Kodi Zgjedhor i njeh të drejtën zgjedhësit që pasi merr fletën e votimit, të shënojë në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhore dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor, shenjën që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Me vendimin nr.19, datë 3.4.2021, “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 08 të partisë socialiste të Shqipërisë, nr. 09 të partisë bindja demokratike dhe nr. 10 të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN) ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021”, KAS vendosi: “Ndryshimin e vendimit nr. 198, datë 01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”; Pranimin e kërkesës ankimore nr. 08, datë 01.04.2021 të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë; Miratimin e fletës së votimit sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi; Pranimin e kërkesës ankimore nr. 09, datë 01.04.2021 të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, duke vendosur në përmbajtje të fletës së votimit logon e ristilizuar të depozituar nga ky subjekt; Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 10, datë 02.04.2021 të paraqitur nga Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim.” Nga analiza ligjore e çështjes KAS-i konstaton se Kodi Zgjedhor ka vendosur hapësirë diskreciale për KQZ-në në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskreciale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesmarrëse mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por Kodi, kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me: fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore (nent 97, pika 1); fleta e votimit duhet të jetë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie (nenet 98, pika 1); emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë (nent 98, pika 3); çdo subjekti që renditet në fletën e votimit duhet t'i korrespondojë hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi (nent 98, pika 3); fleta e

votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (nënt 98, pilia 4).

14. Personi i tretë, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, gjatë gjykimit paraqiti pretendimet e mëposhtme:

Vendimi i KAS është i drejtë, në interpretim të saktë të normës dhe frymës së Kodit Zgjedhor e për pasojë duhet të mbetet në fuqi. Sipas nenit 1, pika 3 e Kushtetutës “Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike”. Zgjedhjet do të konsiderohen të lira edhe kur votuesi është i qartë dhe i bindur për zgjedhjen, pasi fleta e votimit ka qënë qartësisht e perceptueshme prej tij. Garantimin e standarteve kushtetuese në procesin e votimeve, në lidhje edhe me fletën e votimit, e gjejmë tek Kodi Zgjedhor, i ndryshuar, në nenin 98, pika 4. Nga ana e KSHZ u zgjodh varianti i fletës së votimit me emra, por nuk është dhënë asnjë arsyetim ligjor mbi refuzimin e variantit të fletës së votimit me numra. Në asnjë moment nuk është thënë se varianti i fletës së votimit ku kandidati identifikohet me numër është në kundërshtim me ligjin. Përmbajtja dhe konfigurimi i fletës së votimit të miratuar nga KSHZ, ka në përmbajtje një numër të lartë emrash të kandidatëve dhe rrjedhimisht sjell vështirësi substanciale në procesin e përzgjedhjes së kandidatit apo subjektit të preferuar. Pra, votuesi do e ketë tepër të vështirë orientimin në fletë, në mënyrë që shënimi në fletën e votimit të korrespondojë me kandidatin që ai dëshiron që të jetë përfaqësuesi i tij në Kuvend. Fleta e votimit p.sh e qarkut të Tiranës përmban me rreth 500 shënime, vetëm emra kandidatësh dhe numrash që e bën jo të thjeshtë dhe orientuese. Varianti i miratuar nga KSHZ i fletës së votimit krijon një gjendje pabarazie të votuesve në zona zgjedhore apo qarqe të ndryshme. Psh qarku i Kukësi ka numrin më të vogël të kandidatëve dhe fleta ka më pak të dhëna, rrjedhimisht edhe orientimi i votuesit në fletë është shumë më i lehtë sesa psh në Tiranë, Shkodër apo Fier. Varianti i miratuar i fletës së votimit, kërkon më shumë kohë për të ushtruar procesin e votimit dhe krijon rradhë të gjata në qendrën e votimit dhe konfuzion në dhomën e fshehtë të votimit. Po ashtu cenon procesin administrativ të numërimit të shpejtë dhe të drejtë votës. Tërësia e emrave dhe konfigurimi i tyre e bën kohën e verifikimit të fituesit shumë të gjatë dhe ekstraktimi nga fleta i rezultatit rrezikon të çenohet rëndë. KQZ ka detyrim ligjor që të nxjerrë rezultatit për 24 orë. Varianti i fletës së votimit i miratuar vjen në kundërshtim me vendimin nr.168, datë 18 Mars 2021 “Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021” të KSHZ. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankumuar nga asnjë palë e interesuar. Renditja e subjekteve fillon me rend zbritës, nga numri 1 tek numri 12, në mënyrë vertikale, emërtimi i njërit subjekt sipër tjetrit. Ndërsa fleta e votimit të miratuar nuk e respekton konfigurimin e vendosur nga vetë KSHZ. Renditja është bërë publike dhe votuesit e kanë të ngulitur në kokë tashmë. Ky është një tjetër fakt që mbështet qëndrimin se fleta e miratuar e bën votuesin tepër të paqartë dhe konfuz, duke sjell rrezikun që vota e tij të mos numërohet për kandidatin apo subjektin i tij i preferuar. Miratimi i fletës së votimit me përmasa të ndryshme nga ato të miratuara me vendimin nr.6, datë 26.2.2021 të Rregullatorit përbën shkelje, e cila në vetvete përbën shkak ligjor për shfuqizimin e vendimit të Komisionerit nr. 198, datë 01.04.2021. Nga ana tjetër varianti i fletës së votimit me

numra është më i përshtatshëm. Fleta e votimit me numra, duke marrë në konsideratë situatën aktuale, është shumë herë më e qartë dhe e thjeshtë për votuesin kur të paraqitet në dhomën e fshehtë. Koha e përzgjedhjes së kandidatit apo subjektit në qendrën e votimit dihet se është mjaft e shkurtër dhe identifikimi i numrit, duke qënë se është reklamuar pa mbarim nga partitë politike, është mjaft i lehtë. Të gjitha subjektet gjatë fushatave elektorale, nëpër reklama televizive apo radiofonike apo nëpër posterave, e thonë me të madhe “Voto numrin...” “Votoni numrin...” Kjo ndodh pikërisht se votuesit e kanë më të thjeshtë orientimin në fletën e votimit. Pra, varianti i fletës me numër, përveç se e bën fletën e votimit të qartë dhe të thjeshtë për votuesin, e gjen logjikën edhe brenda vetë mënyrës se si zhvillohet fushata zgjedhore nga të gjitha subjektet. Fleta e votimit me numra, është në përputhje me vendimin nr. 168, datë 18 Mars 2021 të KSHZ pasi emrat e subjekteve zgjedhore janë të konfiguruar në përputhje me konfigurimin e tyre në këtë vendim. Votuesi është njohur me renditjen e subjekteve dhe rrjeshtimin e tyre me rend zbritës dhe fleta e votimit me numëra nuk rrezikon përzgjedhjen e kandidatit në dhimën e fshehtë. Duke qënë kështu, varianti i fletës së votimit, nga ku kandidatët identifikohen me numra, plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për një proces të drejtë, të lirë dhe të barabratë, pikërisht nëpërmjet qartësisë dhe thjeshtësisë që prezanton konfigurimi i saj. Pala e tretë më tej i qëndroi argumentimit të bërë nga KAS në vendimin nr. 19, datë 3.04.2021 për miratimin e fletës së votimit me numra dhe shtoi se përveç argumentimit ligjor të bërë nga KAS për ndryshimin e vendimit nr. 198 datë 1.4.2021, madhësia e fletës së votimit me emra, kompromenton fshehtësinë e votimit, ngarkon administrimin përgjatë numërimit të votave dhe rrit potencialin manipulativ në numrim, veçanërisht për votat parapëlqyese të kandidatit. Modeli i miratuar nga KSHZ me përmasat rrit në mënyrë të pajustificueshme koston e prodhimit të tyre. Komisioneri duhet të kishte analizuar, eksperimentuar dhe zgjidhur pozitivisht eliminimin e ktyre rreziqeve të procesit, përpara se të miratonte fletën e votimit. Zvogëlimi i madhësisë së fontit të fletës së votimit, me qëllim që të sistemohen emrat e të gjithë kandidatëve që garojnë në zonën zgjedhore shkon dy herë në dëm të zgjedhësve, një herë për shkak të zvogëlimit të gërmës, të dytën për shkak të tejmbushjes me informacion.

15. Personi i tretë, Partia Bindja Demokratike në gjykim parashtrori se vendimi i KAS nr. 19, datë 3.4.2020 ka pranuar kërkesën e saj për përdorimin e logos që e identifikon. Mes logove nuk ka ngjashmëri, por për të shmangur mosmarrëveshjes me koalicionin “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim “PD-AN”, Partia Bindja Demokratike ka ristilizuar logon, e cila më pas është ndryshuar nga KSHZ me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 pa marrë ndonjë vendim që logot kishin ngjashmëri dhe pa dijeninë e subjektit zgjedhor. Logot nuk janë të ngjashme, sipas neni 66 të Kodit Zgjedhor, por nëse koalicion “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim “PD-AN” pretendon se janë të tilla është ky subjekt që duhet të ndryshojë logon. Kjo pasi Partia Bindja Demokratike është subjekt zgjedhor i regjistruar në zgjedhjet e mëparshme të mbajtura 30 qershor 2019, ndërkohë koalicionin “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim “PD-AN” është regjistruar për herë të parë në këto zgjedhje. Në kuptim të nenit 66 të Kodit Zgjedhor është ky koalicion që duhet të ndryshojë logon. Logo e Partisë Bindja Demokratike që është vënë në

fletën e votimit të miratuar nga KSHZ nuk e përfaqëson këtë subjekt zgjedhor dhe prandaj fleta e votimit duhet të ketë logon e miratuar nga KAS me vendimin nr. 19, datë 3.4.2021.

16. Ndërhyrësi dytësor, subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim gjatë gjykimit paraqiti pretendimet e mëposhme:

Vendimi nr. 19, datë 03.04.2021 i KAS është një vendim i marrë jo në përputhje me Kodin Zgjedhor. Me ndryshimet e kryera në Kodin Zgjedhor është përfshirë koncepti i “votës parapëlqyese”. Sipas këtyre ndryshimeve ligjore rezulton se subjektet zgjedhore, për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, do të garojmë me lista shumemërore dhe votimi do të jetë si për subjektin zgjedhor ashtu edhe për kandidatin e tyre. Përfshirja e konceptit të “votës parapëlqyese” për kandidatët, referuar ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, që nga momenti i paraqitjes së listave të kandidatëve e deri në mënyrën e votimit apo vlerësimin e votës, kërkon si kusht të domosdoshëm krahas subjektit zgjedhor edhe identifikimin e kandidatit. Parashikimet ligjore të sipërcituara janë parakushte dhe kërkesa imperative në momentin e miratimit të përmbajtjes së fletës së votimit të vendoset emër mbiemër i kandidatit. Vlerësohet se pikërisht në këto argumente dhe parashikime ligjore është bazuar edhe KSHZ kur e ka miratuar fletën e votimit me përmbajtje të emrave të kandidatëve. Ndërkohë që vendimi i KAS për miratimin e fletës së votimit, me përmbajtje të numrave si identifikim për kandidatët është në kundërshtim me frymën dhe bazën ligjore të sanksionuar në Kodin Zgjedhor. Vendimi i KAS duke konsideruar si numra kandidatët e listave shumë emërore të subjekteve zgjedhore garuese në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021, ka shpëfillur vullnetin e ligjvënësit, konsensusin politik të arritur me marrëveshjen e Këshillit Politik si dhe duke konsideruar si numra kandidatët e listave. Fleta e votimit me emra kandidatësh nuk çorienton zgjedhësin. Fleta e votimit me numra është plotësisht jo në përputhje me frymën e kodit dhe vullnetin e ligjvënësit dhe sjell në humbjen e konceptit të ivotës parapëlqyese për kandidatin e subjektit politik.

II VLERESIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR

17. Kolegji vë në dukje se para tij shtrohen për zgjidhje dy mosmarrëveshje. Çështja e pasqyrimin me emra apo me numra të listës shumemërore të kandidatëve të subjekteve zgjedhor në fletën e votimit, si dhe mosmarrëveshja në lidhje me logon e subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike, e pasqyruar në fletën e votimit.

A) Mosmarrëveshja në lidhje me pasqyrimin e kandidatëve në fletën e votimit.

18. Sa i përket pretendimeve të paditësit në lidhje me paligjshmërinë e vendimit nr.19, datë 3.4.2021 të KAS për ndryshimin e vendimit nr.198, datë 1.4.2021 të KSHZ në lidhje me fletën e votimit, Kolegji e gjen me vend të theksojë paraprakisht se kompetenca lëndore dhe funksionale e Kolegjit, nuk shtrihet në vlerësimin subjektiv të gjykimeve dhe vlerësimeve diskrecionale të KSHZ, të cilat nuk provohet se dëmtojnë procesin zgjedhor. KSHZ-së i është ngarkuar detyra e

menaxhimit konkret të procesit zgjedhor, nga pikëpamja administrative dhe për rrjedhojë ai në ushtrimin e detyrës së tij, ka përgjegjësinë të marrë edhe vendime me karakter diskrecionar. Në nenin 12(3) të Kodit Zgjedhor është parashikuar se: “[k]omisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) është organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.” Ndaj është krejt e natyrshme që gjatë ushtrimit të kompetencave ekzekutive, Komisioneri të ushtrojë një hapësirë diskrecioni, në kuptim të nenit 3(3) të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se: “[d]iskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.” Si rregull Kolegji nuk mund të rrëzojë vlerësimet e KSHZ-së bazuar vetëm në hamendësime apo vlerësime subjektive të ndryshme të të njëjtave fakte, pa pasur të paraqitura prova konkrete që nxjerrin në pah shkelje ligjore të vendimeve të KSHZ-së. Natyrisht që fletët e votimit janë provë në vetvete për zgjedhjen e bërë nga KSHZ dhe KAS e Kolegji mund t’i vlerësojnë ato vetëm në drejtim të evidentimit të shkeljeve potenciale ligjore, për të cilat janë ankuar palët, e që ndikojnë rëndë në procesin zgjedhor.

19. Referuar sa më sipër, Kolegji vlerëson se është pjesërisht i bazuar vendimi i KAS në lidhje me ndryshimin e fletës së votimit të miratuar nga Komisioneri, duke e zëvendësuar atë me një fletë votimi ku vota parapëlqyese për kandidatët për deputetë, pasqyrohet me numra. KAS ka të drejtë kur ka konstatuar shkelje nga ana e Komisionerit të vendimit nr.6, datë: 26.02.2021 të Komisionit Rregullator (në vijim Rregullatori) pranë KQZ, sipas të cilit dimensionet e miratuara të fletës së votimit janë: 1) gjerësia 297 mm dhe 2) gjatësia 420 mm. Siç shihet nga pjesa arsyetuese e vendimit të Rregullatorit, në marrjen e këtij vendimi ai është bazuar edhe në nenin 97(1) të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit “[p]ër zgjedhjet për Kuvendin, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore.” Pretendimi i paditësit se vendimi i mësipërm i Rregullatorit kishte më shumë karakter orientues sesa detyrues, nuk qëndron, pasi ky akt nuk shprehet në terma të tillë. Vendimi i Rregullatorit ka normuar kuptimin e shprehjes “formë të njëjtë”, e cila nuk ka kuptimin vetëm të formës gjeometrike të fletës së votimit, por edhe të përmasave reale të kësaj forme gjeometrike. Ndaj, Komisioneri nuk mund të hartonte një fletë votimi si ajo që ka miratuar, duke cenuar përmasat e përcaktuara paraprakisht nga Rregullatori. Në zbatim të nenit 12(4) të Kodit Zgjedhor, nëse KSHZ do të vërente se përmasat e fletës së votimit të miratuar nga Rregullatori, përbënin problem për përpilimin e saj, duhej të vinte në lëvizje këtë organ kolegjal, në mënyrë që ai të bënte një rregullim tjetër. Fakti që Rregullatori edhe kur i është paraqitur fleta e votimit në disa variante për miratim nga Komisioneri, ka shpallur moskompetencën e vet, lë të kuptohet se ka ardhur në dijeni të dimensioneve të ndryshme të disa varianteve në raport me variantin e votimit me numra dhe ka zgjedhur të mos ndryshojë vendimin e mëparshëm nr.6, datë: 26.02.2021, në lidhje me specifikimet e fletës së votimit. Kësisoj, ka qenë e pamundur për KSHZ-në që të miratonte një fletë votimi me përmasa më të mëdha se “297 mm x 420 mm”, ndaj për këtë pjesë është i drejtë vendimi i KAS që ka ndryshuar vendimin e Komisionerit.

20. Kolegji vëren se nga tre variantet e fletëve të votimit që ka paraqitur Komisioneri, vetëm njëri (*ai i zgjedhur nga KAS*) kishte përmasat e paracaktuara me vendimin nr.6, datë: 26.02.2021 të Rregullatorit. Për sa kohë që ky vendim ishte në fuqi dhe i pandryshuar nga Rregullatori, Komisioneri kishte detyrimin t'i përmbahej atij. Fakti që nuk i është përmbajtur një akti normativ nënligjor të dalë në bazë e për zbatim të nenit 97(1) të Kodit Zgjedhor, e bën të paligjshëm vendimin e KSHZ dhe justifikon ndryshimin e tij nga KAS.

21. Kur rregullat e paracaktuara janë të qarta në kuptimin literal të tyre (përmasat 297 mm x 420 mm), ai është kuptimi që duhet të gjejë zbatim nga ekzekutivi i KQZ. Gjykata u vu para zgjedhjes midis versionit të Komisionerit dhe atij të KAS, e nuk u paraqit ndonjë alternativë tjetër. Gjykata pyeti palët në seancë gjyqësore, nëse ishte e mundur që fleta e votimit e miratuar nga KSHZ, të sillej në përmasat 297 mm gjerësi me 420 mm gjatësi, duke mos humbur qartësinë dhe efektivitetin që duhet ta karakterizojë dhe palët nuk ishin në gjendje të jepnin një shpjegim të qartë në lidhje me këtë. Ndaj, para Kolegjit u shtrua çështja nëse fleta e votimit duhet të jetë apo jo sipas specifikimeve teknike të paracaktuara nga Rregullatori, apo mund të dalë tej tyre? Personi i interesuar PS e portretizoi fletën e votimit të miratuar nga KSHZ si “gazetë” që ishte e vështirë të lexohej, ndërsa lavdëroi fletën e votimit të miratuar nga KAS. Paditësi dhe ndërhyrësi dytësor LSI pretenduan se fleta e votimit e miratuar nga Komisioneri është më e qartë dhe në përputhje me frymën e ligjit, ndërsa ajo e miratuar nga KAS nuk i ka këto cilësi. Në lidhje me këtë do të ishte e lehtë për Kolegjin që të mbivendoste vlerësimin e vet subjektiv mbi atë të KSHZ-së dhe KAS dhe për rrjedhojë të ndryshonte çdo vendimmarrje të tyre që nuk i duket e përshtatshme. Mirëpo, ky nuk është roli i Kolegjit, por ky rol fokusohet tek shkeljet eventuale ligjore të kryera nga KSHZ, të cilat janë të rëndësishme dhe që ndikojnë në procesin zgjedhor. Të tilla shkelje është e nevojshme të argumentohen e provohen para Kolegjit, në mënyrë që ky i fundit të mund të krijojë bindjen bazuar në kritere ligjore për ligjshmërinë apo paligjshmërinë e akteve të KQZ.

22. Kolegji vëren se përpara se të diskutohet përmbajtja e fletës së votimit, nëse do të ketë të shënuar apo jo emrat e kandidatëve për deputetë (*për efekt të votimit parapëlqyes*), duhet të vlerësohet nëse përmasat e saj janë aq sa është përcaktuar paraprakisht në bazë e për zbatim të Kodit. Nga provat e administruara gjatë gjykimit rezultoi se fleta e votimit e miratuar nga KSHZ i kishte përmasat 297 mm gjerësi me 600 mm gjatësi, ndërsa ajo e miratuar nga KAS ishte më përmasat fikse sipas vendimit nr.6, datë: 26.02.2021 të Rregullatorit 297 mm gjerësi me 420 mm gjatësi. Ky fakt në vetvete e bën të paligjshëm vendimin e KSHZ, pasi ky i fundit ka dalë tej parashikimeve të akteve rregullatore të procesit zgjedhor.

23. Referuar sa më sipër, Kolegji çmon se fleta e votimit e miratuar nga KAS është konform akteve nënligjore në fuqi, që kanë normuar përmasat e kësaj flete, ndërsa fleta e miratuar nga KSHZ e cenon këtë standard. Ndaj, Kolegji çmon të lërë në fuqi vendimin e KAS dhe të rrëzojë padinë e PD-AN në lidhje me këtë pjesë të kërtimeve të tyre.

24. Nga ana tjetër, Kolegji nuk bashkohet me qëndrimin dhe arsyetimin e KAS në lidhje me të metat e tjera të përmbajtjes së fletës së votimit të miratuar nga KSHZ. Në gjykim nuk është provuar sa arsyeton KAS se fleta e miratuar nga KSHZ rrezikon procesin e votimit, apo nuk është konform standardeve ligjore që kërkon neni 98 i Kodit Zgjedhor. Vlerësimet paraprake të kësaj natyre, të pambështetura nga prova empirike të vërtetuara, nuk mund të bëhen pjesë e gjykimit të organeve që shqyrtojnë ankimet në procesin zgjedhor. Të metat hipotetike të fletës së votimit të miratuar nga Komisioneri, nuk përbëjnë shkak për rrëzimin e saj, ndaj për këtë pjesë arsyetimi i KAS nuk qëndron. Si përmbajtja e fletës së votimit të zgjedhur nga Komisioneri ashtu edhe ajo e miratuar nga KAS, kanë anët e tyre pozitive dhe negative. Asnjëra prej tyre nuk është e pakritikueshme.

25. Kolegji i gjen të mbështetura në ligj të dy përmbajtjet e fletëve të votimit, si asaj të miratuar nga KSHZ ashtu edhe asaj të miratuar nga KAS, por vlerëson se, nëse nuk do të kishte të meta formale (*përmasat e fletës së votimit në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi*) organet e ankimit duhej të kishin respektuar diskrecionin e Komisionerit, sa kohë që nuk provohej qartazi se zgjedhja e Komisionerit ishte në kundërshtim me ligjin dhe dëmtonte rëndë procesin zgjedhor.

26. Në përfundim Kolegji çmon të theksojë se një faktor tjetër i rëndësishëm që u mbajt parasysh nga ne për marrjen e vendimit përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ishte edhe pohimi gjyqësor në seancë nga përfaqësuesi i KQZ-së, se kompania e huaj e prodhimit të fletëve të votimit, i kishte bërë me dije se nëse fletët e votimit do të kishin dimensionet 297 mm gjerësi me 600 mm gjatësi (aq sa i kishte miratuar Komisioneri), nevojitej një kohë e gjatë për sigurimin e bazës së nevojshme materiale. Kjo praktikisht e vuri Kolegjin para përgjegjësisë për fatin e zgjedhjeve të 25 prillit, pasi nëse do të pranohej fleta e votimit e miratuar nga Komisioneri, kompanisë prodhuese do t'i duheshin edhe minimalisht 2 javë kohë për të siguruar letrën në përmasat e reja, e më pas të fillonte printimin e tyre dhe transportin në Shqipëri. Kjo alternativë do të thoshte se më 25 prill 2021 nuk do të mund të zhvilloheshin dot zgjedhje në Shqipëri, çka është një opsion i papranueshëm për Kolegjin. Po ashtu u pohua në seancë nga përfaqësuesi i KQZ se tenderimi i fletëve të votimit ishte bërë sipas specifikimeve teknike të vendosura nga Rregullatori me vendimin nr.6, datë: 26.02.2021, çka nxjerr edhe njëherë në pah faktin se KSHZ në vendimmarrjen e tij, duhej të kishte marrë parasysh një shumë faktorësh më të gjerë se sa ka marrë për bazë kur mori vendimin nr.198, datë 1.4.2021.

B) Mosmarrëveshja në lidhje me logon e Partisë Bindja Demokratike të pasqyruar në fletën e votimit.

27. Sa i përket pretendimit të paditësit për paligjshmërinë e vendimit nr.19, datë 3.4.2021 të KAS në lidhje me logon e Partisë Bindja Demokratike, të miratuar për t'u pasqyruar në fletën e votimit, Kolegji thekson se është i bazuar. Neni 98 pika 3 e Kodit Zgjedhor parashikon ndër të tjera se *në fletën e votimit përbri emrit të partisë vendoset sigla (pra logo), shkronja nistore dhe*

emri i kryetarit të partisë. Kolegji vë në dukje se i njëjti rregull vlen dhe kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili kur regjistrohet, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të tij, e cila për nevoja të zbatimit të këtij Kodi përmbush të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi për subjektet zgjedhore. Pra, fleta e votimit do përmbajë ndër të tjera dhe logon që përfaqëson koalicionin në zgjedhje. Nga ana tjetër neni 66 i Kodit Zgjedhor parashikon se *nëse dy parti politike ose koalicione kanë emër ose emblemë të njëjtë apo të ngjashme në atë masë saqë mund të shkaktojë konfuzion ose lajthitje të votuesve, atëherë KQZ-ja vendos cila parti ose cili koalicion ka të drejtë të përdorë emrin ose emblemën përkatëse për qëllime zgjedhore, duke marrë në konsideratë datën e themelimit ligjor të partive ose datën e regjistrimit të parë të koalicionit në KQZ. Për të përcaktuar datën e parë të regjistrimit të koalicioneve, KQZ-ja i referohet edhe zgjedhjeve të mëparshme.* Sipas këtij rregullimi ligjor nuk lejohet të garojnë në zgjedhje dy subjekte zgjedhore me logo të njëjtë apo të ngjashme. Për pasojë ndalohet që këto subjekte zgjedhore të kenë logo të ngjashme edhe në fletën e votimit. Kjo me qëllim që votuesve të mos u krijohet konfuzion dhe për rrjedhojë të ngatërrojë subjektin, të cilin kanë vullnetit t'i japin votën. Kolegji vë në dukje se nëse dy subjekte zgjedhore kanë logo të njëjta apo të ngjashme, në kuptim të nenit 66 të Kodit Zgjedhor lejohet të përdor logon ai subjekt zgjedhor a) në rastin e partive që është themeluar ligjërisht më parë dhe b) në rastin e koalicioneve që është regjistruar më parë në KQZ referuar zgjedhjeve të zhvilluara më parë ndër vite. Ky rregullim ligjor parashikon si kriter objektiv vlerësues kohëzgjatjen e përdorimit të logos nga subjekti zgjedhor. Kjo, pasi një subjekt zgjedhor që e ka përdorur logon për qëllime zgjedhore për një periudhë më të gjatë është më tepër i identifikuar me logon e tij tek votuesit. Në rastin në gjykim logo e pretenduar e ngjashme është mes një partie dhe një koalicioni. Konkretisht pala paditëse, koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN) pretendon se logo e Partisë Bindja Demokratike, në fletën e votimit të miratuar nga KAS, është e ngjashme me logon që e përfaqëson këtë koalicion, që është logo e Partisë Demokratike, e cila është partia udhëheqëse e koalicionit.

28. Kolegji thekson se KAS me vendimin nr. 19, datë 3.4.2021 ka miratuar fletën e votimit me logon e ristilizuar të Partisë Bindja Demokratike, e cila është e ndryshme nga logo që ka miratuar KSHZ me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021. Në gjykim rezultoi se mbi kërkesën e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN), KSHZ i ka kërkuar Partisë Bindja Demokratike të ndryshojë logon dhe kjo e fundit e ka ristilizuar atë dhe e ka paraqitur pranë KQZ. KSHZ në fletën e votimit, pasi ka vlerësuar që logo e ristilizuar ka qenë e ngjashme me logon e koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN) nuk e ka vënë këtë logo në fletën e votimit, por një tjetër. KAS ka ndryshuar vendimin e KSHZ duke vënë në fletën e votimit logon e ristilizuar nga Partia Bindja Demokratike.

29. Kolegji konkludon se logo e ristilizuar e Partisë Bindja Demokratike e miratuar nga KAS është e ngjashme me logon e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN). Kolegji arrin në këtë konkluzion bazuar në mënyrën si janë stilizuar gërmat “P” dhe “D” në logon e Koalicionit, e cila krijon një hapësirë me ngjyrë të bardhë, që ngjason me gërmën “D” e

bardhë që ndodhet brenda hapërsirës së gërmës “B” të logos së Partisë Bindja Demokratike. Duke pasur parasysh përmasat e vogla që kanë logot në fletën e votimit ngjashmëria mes logove bëhet e konsiderueshme. Fjalët “Bindja Demokratike” në pjesën e poshtme të logos së kësaj partie, si dhe ngjyra bojëqielli e saj në krahasim me atë blu të logos së koalicionit nuk shmanjin konfuzionin që krijohet tek votuesi, për bërë dallimin mes tyre. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se këto subjekte nuk mund të garojnë me logo të ngjashme sipas miratimit të tyre nga KAS me vendimin nr. 19, datë 3.4.2021.

30. Për pasojë, mes këtyre dy subjekteve zgjedhore, në kuptim të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, Kolegji përcakton se është koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN) që duhet të mbajë logon. Kjo, pasi përzgjedhja bëhet midis një partie dhe një koalicioni, i cili si logo ka atë të partisë udhëheqëse të tij që është Partia Demokratike, e cila e përdor logon e saj që në vitin 1991 në zgjedhjet vendore dhe qendrore, ndërsa Partia Bindja Demokratike është një parti e re që merr pjesë në zgjedhje për herë të dytë.

31. Nga ana tjetër, logo e Partisë Bindja Demokratike e vendosur në fletën e votimit nga KSHZ sipas vendimit nr. 198, datë 1.4.2021 dukshëm nuk ka ngjashmëri me logon e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN). Kjo logo ka shkronjën “D”, të plotë, me ngjyrë bojëqielli brenda gërmës “B”, të bardhë. Këto dy gërma janë të vendosura brenda një fushe katrore bojëqielli dhe në pjesën e poshtme të saj është shkruar me të bardha emri i Partisë Bindja Demokratike.

32. Në analizë të sa më sipër, duke qenë se fleta e votimit duhet të përmbajë logon e subjekteve zgjedhore, Kolegji konkludon se logo e subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike e vënë në fletën e votimit me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 të KSHZ është logo që ky subjekt zgjedhor duhet të mbajë në fletën e votimit. Për pasojë vendimi nr. 19, datë 3.4.2021 i KAS duhet të shfuqizohet në pikën 3 (sipas vendimit të paraqitur si provë nga KQZ), me të cilën ka pranuar ankesën e Partisë Bindja Demokratike dhe ka vendosur në fletën e votimit logon e ristilizuar, të ngjashme me atë të palës paditëse koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN). Kolegji thekson se nuk qëndron pretendimi i Partisë Bindja Demokratike se logo e vendosur në fletën e votimit me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 nga KSHZ nuk e përfaqëson. Kjo, pasi nëse dy subjekte kanë logo të ngjashme njëri prej tyre nuk mund ta përdorë logon që e ka përfaqësuar më parë, por do përdorë një logo që do e përfaqësojë në fletën e votimit vetëm për qëllime zgjedhore. Logo e Partisë Bindja Demokratike e vendosur në fletën e votimit me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 të KSHZ ka shkronjat nistore BD të kësaj partie, emrin e kësaj partie, ka ngjyrë bojëqjelli (ngjyrë që e kishte zgjedhur kjo Parti më parë në logon e ristilizuar). Elementët e mësipërm janë të pranishme edhe me siglën, në vulën e kësaj Partie, e konstatuar në autorizimin e lëshuar nga Kryetari i saj për përfaqësuesin në këtë gjykim. Pra, Kolegji vlerëson se logo e mësipërme për efekt të pasqyrimin në fletën e votimit, e përfaqëson subjektin zgjedhor Partia Bindja Demokratike. Madje kësaj të fundit iu dha mundësia nga KSHZ të ndryshonte

logon e saj, por ajo paraqiti logon e ristilizuar, e cila nga Kolegji, ashtu si dhe nga KSHZ, u gjet e ngjashme me logon e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD – AN).

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,

V E N D O S I

Pranimin pjesërisht të padisë.

Shfuqizimin e vendimit nr.19, date 03.04.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në lidhje me pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr.198, datë 01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me logon me të cilën do të garojë Partia Bindja Demokratike në zgjedhjet për Kuvendin datë 25 prill 2021.

Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall, në Tiranë më datë 04.04.2021.

GJYQTARE

Manjola XHAXHO
(Pjesërisht kundër)

GJYQTARE

Esmeralda XHILI

GJYQTARE

Alma KOLGJOKA

GJYQTAR

Asim VOKSHI

GJYQTAR

Gentian MEDJA

MENDIM PAKICE

1. Unë gjyqtare Manjola Xhaxho, duke qenë se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën vetëm në lidhje me pasqyrimin e kandidatëve të parapëlqyer me emra në fletën e votimit, duke u lënë kështu në fuqi vendimi nr. 19, datë 3.4.2021 i KAS, paraqes argumentet e mëposhtme:

2. Shumica pranon se fleta e votimit e miratuar nga Komisioneri Shtetëror Zgjedhjeve (KSHZ) me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 për nga përmbajtja e saj është e ligjshme në kuptim të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, por është e paligjshme, pasi përmasat e saj, që janë 297 mm gjatësi me 600 mm gjerësi, nuk përputhen me ato të miratuara me vendimin nr. 6, datë 26.2.2021 nga Komisioni Rregullator (Rregullatori), që janë nga 297 mm gjerësi dhe 420 mm gjatësi. Madje shumica argumenton ndër të tjera se nëse nuk do të kishte të meta formale, fleta e votimit e miratuar nga KSHZ, pra me emrat e kandidatëve të parapëlqyer në të, duhet të respektohej nga organet e ankimit, pra nga KAS apo vet Kolegji duke respektuar kështu diskrecionin e KSHZ në këtë vendimmarrje, sa kohë që nuk provohet qartazi se zgjedhja e KSHZ të ishte në kundërshtim me ligjin dhe dëmtonte rëndë procesin zgjedhor.

3. Ndryshe nga shumica vlerësoj se KSHZ ka miratuar me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 një fletë votimi të ligjshme edhe përsa i takon përmasave të saj. Konkretisht neni 97 pika 1 i Kodit Zgjedhor parashikon se *për zgjedhjet për Kuvendin, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore*. Neni 98 në vijim rregullon në nenin 1 të tij se *fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja dhe se fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së*. Pra, Kodi Zgjedhor, në nenin 98 parashikon detyrimin e Rregullatorit pranë KQZ-së, që është organi, i cili nxjerr aktet normative sipas nenit 12 pika 4 e këtij Kodi, që të normojë me akt përkatës elementet e sigurisë së fletës së votimit. Kjo ka ndodhur, kur Rregullatori me vendimin nr. 6, datë 26.2.2021 ka miratuar specifikimet teknike të fletës së votimit duke përcaktuar llojin e letrës dhe specifikimet të tjera si barkodi etj. Në këtë vendim janë përcaktuar edhe dimensionet e fletës së votimit prej 297 mm gjerësi dhe 420 mm gjatësi. Po ashtu në këtë vendim në pikën 2 të tij Rregullatori ka vendosur që mund të ndryshojë përmasat e fletës së votimit në varësi të listave shumemërore për çdo zonë zgjedhore. Në lidhje me kërë çështje, nga procesverbali datë 26.2.2021, i mbledhjes së Rregullatorit¹, rezulton se në momentin e miratimit të këtij vendimi nuk ishte i qartë ende numri i kandidatëve në listat shumemërore dhe është lënë mundësia për rishikim të përmasave të fletës së votimit në varësi të këtyre listave. Pas përfundimit të listave, KSHZ pranë KQZ me një projektvendim, në bazë të nenit 98 pika 1 të Kodit Zgjedhor, ka

¹ Procesverbali i mbledhjes date 26.2.2021 e Rregullatorit gjendet ne faqen zyrtare te KQZ ne linkun ne vijim <http://kqz.gov.al/ëp-content/uploads/2021/04/Procesverbali-i-mbledhjes-se-Komisionit-Rregullator-ne-date-26.02.2021..pdf>

përgatitur përmbajtjen e fletës së votimit në tre variante një landscape (horizontalisht) dhe një portrait (vertikalisht) në përmasat 297mm X 600 mm duke përfshirë në të emrat dhe mbiemrat e kandidatëve parapëlqyes për secilin subjekt zgjedhor dhe një variant në përmasat 297 mm X 420 mm duke përfshirë në të numra (pa emra) për kandidatët parapëlqyes të subjekteve zgjedhore. KSHZ i ka kërkuar Rregullatorit që të miratojë një nga variantet e fletës së votimit në kuptim të nenit 98 të Kodit Zgjedhor. Rregullatori me vendimin nr. 12 , datë 31.3.2021 ka shpalur moskompetencën për shqyrimin e këtij projekvendimi të KSHZ me argumentin se është kompetencë e KSHZ të miratojë fletën e votimit dhe sipas nenit 98 pika 1 Rregullatori ka detyrim të miratojë vetëm elementët e fletës së sigurisë. Ndryshe nga shumica vlerësojë se vendimi i mëparshëm nr. 6, datë 26.2.2021 i Rregullatorit që ka miratuar specifikimet teknike të fletës së votimit nuk është detyrues për KSHZ, përse i përket përmasës së fletës së votimit. Kjo, pasi përmasa e fletës së votimit është një element që nuk parashikohet në nenin 98 pika 1 i Kodit Zgjedhor, që duhet të rregullohet me akt normativ nga Rregullatori. Kjo është e kuptueshme, pasi siç është diskutuar nga anëtarët e Rregullatorit gjatë mbledhjes për marrjen e vendimit nr. 6, datë 26.2.2021², përmasa e fletës së votimit lidhet me përmbajtjen e saj, pra me përfshirjen e kandidatëve parapëlqyer në të. Kodi Zgjedhor në parashikimet e mësipërme të tij në lidhje me fletën e votimit nuk përmend përmasat e fletës së votimit. Kjo lë të kuptohet se duke qenë se përmasat e fletës së votimit ndryshojnë në varësi të përmbajtjes, atëherë KSHZ kur përgatit fletën e votimit përcakton përmasën e saj. Nuk jam dakort me qëndrimin e shumicës se me vendimin nr. 6 , datë 26.2.2021 Rregullatori ka interpretuar shprehjen “formë e njëjtë”, e cila nuk merr kuptimin vetëm të formës gjeometrike të fletës së votimit, por edhe të përmasave reale të kësaj forme gjeometrike, pasi *së pari* ky interpretim nuk gjendet gjëkund në vendimin e Rregullatorit, pra nuk është bërë një interpretim i tillë as nga vet Rregullatori dhe *së dyti* një interpretim i tillë nuk mund të bëhet pasi vërtet ligji bën fjalë për formë të njëjtë të fletës së votimit, por përmasa e saj do të jetë në varësi të përmbajtjes që ka fleta. Rithekoj se përmasën e fletës së votimit duhet ta përcaktonte KSHZ që do hartonte fletën e votimit dhe jo Rregullatori. Madje ky i fundit nuk ka detyrim të rregullojë me akt normativ as formën që duhet të ketë fleta e votimit, pasi ligji nuk i ka dhënë një kompetencë të tillë. Neni 98 është i qartë Rregullatori normon me akt normativ elementët teknik të sigurisë së fletës së votimit, ndërkohë përmbajtja, forma, përmasat e fletës së votimit janë në diskrecion të KSHZ. Vendimmarrjen e këtij të fundit, në këtë drejtim, duhet t’u respektojnë si KAS dhe Kolegji, sa kohë që nuk provohet se fleta e votimit e miratuar nga KSHZ është në kundërshtim me ligjin.

4. Më tej në pikat 3 dhe 4 të Kodit Zgjedhor parashikohet përmbajtja e fletës së votimit. Konkretisht sipas pikës 3 të nenit 98 fleta e votimit duhet të përmbajë *emrat e subjekteve zgjedhor, sipas rendit të përcaktuar nga shorti, sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë dhe hapësirën përkatëse për shënimin e votës nga votuesit*. Sipas pikës 4 fleta e votimit duhet të përmbajë *hapësirë të posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i*

² Ibid 1

subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimi të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimit e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer. Fleta e votimit e miratuar nga KSHZ me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 përmban elementet e parashikuara nga këto rregullime ligjore. Në lidhje me pretendimet e palëve për paligjshmëri të fletës së votimit të miratuar nga KSHZ për shkak se fleta e votimit bëhet e ngarkuar, e paqartë e vështirë për t'u kuptuar nga zgjedhësit etj., ashtu si shumica çmoj se këto janë vlerësime subjektive të pambështetura në prova empirike dhe për pasojë vendimmarrja e KSHZ-së nuk mund të kundërshtohet bazuar në to.

5. Një çështje tjetër me të cilën nuk bie dakort me shumicën është edhe trajtimi që i bën përgjigjes në seancë gjyqësore së përfaqësuesit të KQZ në lidhje me një letër që ishte bërë publike në media për pamundësinë e kompanisë tenderuese për të prodhuar fletët e votimit në rast se ato do të ishin në përmasa më të mëdha se ato të miratuara me vendimin nr. 6, datë 26.2.2021 të Rregullatorit. Pra, e thënë ndryshe nëse do ishin në përmasat e fletës së votimit të miratuar nga KSHZ me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021. Së pari vlerësoj se duke qenë se çështja e prodhimit apo jo e fletëve të votimit nuk ishte objekt gjykimi, Kolegji ishte në pamundësi të verifikonte situatën ligjore, kontraktuale dhe faktike të shoqërisë tenderuese për përmbushjen ose jo të detyrimeve për prodhimin e fletës së votimit, si dhe shkaqeve përkatëse. Së dyti një çështje e tillë nuk ka lidhje me ligjshmërinë e vendimit nr. 198, datë 1.4.2021 të KSHZ, që Kolegji kishte për shqyrtim. Madje në vështimin tim këtë çështje që është tërësisht teknike, administrative e ka në diskrecion KQZ dhe nuk i përket Kolegjit ta trajtojë për zgjedhje në kuptim të Kodit Zgjedhor.

6. Sa më sipër, vendimi nr. 19, datë 3.4.2021 i KAS duhet të shfuqizohet tërësisht dhe të lihej në fuqi vendim nr. 198, datë 1.4.2021 i KSHZ-së.

GJYQTARE

Manjola XHAXHO